REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fag/Br.str. 372
Data/Datum 20. 11. 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE

MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 01.09.2026, në ora 10:00h, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Filloreta Musaj, Rrahim Sogojeva, Laureat Gojnovci, Dardane Sogojeva Shala dhe Ali Ismaili.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Sabri Xhigoli - Drejtor për Arsim dhe Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis.

Të tjerë:

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e datës 29.07.2026.
2. Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026.
3. Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026.
4. Propozim për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë.
5. Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2026-2030.
6. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, po e hapim zyrtarisht mbledhjen, po filloj me leximin e pikave të rendit të ditës dhe hapi diskutimin.

Rrahim Sogojeva: Përshëndetje kolegë, ne pajtohemi me rendin e ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, ne jemi dakort për shqyrtim të pikave të propozuara.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, sa i përket pikave të rendit të ditës të propozuara për shqyrtim edhe unë pajtohemi që të aprovohen.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pajtohem me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, por duhet ta kemi një standard të vendosim në bazë të rregullave të punës së Kuvendit, jo të shqyrtojmë material që nuk janë të plota.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, theksoi se tani po e qesim në votim rendin e ditës të propozuar për shqyrtim në mbledhjen e sotme.
U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave aprovohet për shqyrtim rendi i ditës në mbledhjen e sotme të Komitetit për Politikë dhe Financa

Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 29.07.2026.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtim për vërejtjet apo sugjerimet tuaja 'Ekstraktin e Procesverbalit të mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e mbajtur me datën 29.07.2026'. Hap diskutimin.
Rrahim Sogojeva: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovimin 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 29.07.2026'.
Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, ne nuk e votojmë, ekstraktin e procesverbalit, sepse po shkelet Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës.
Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Mendoj që është shkelur Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës, nuk po bëhen audio-incizimet, andaj ne jemi kundër.
Ali Ismaili: Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 29.07.2026, nuk kam vërejtje, por po kalojnë nëntë muaj dhe nuk ka ndonjë përmirësim esencial nga e kaluara, andaj unë do të abstenoi.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e qesim në votim për aprovim 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 29.07.2026'.
U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoj se aprovohet 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 29.07.2026'.

Pika e dytë (2) - Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026', ftoj Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, që të na jap sqarime.
Drejtori për Arsim: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Disa shkolla aktualisht janë me mungesë të invertarit sikur është shkolla 'Mihal Grameno' dhe Anekset e saj, po ashtu e kemi edhe shkollën e re në rrugën 'Fazli Grajçevci', ku nuk është paraparë furnizimi me invertarë, duke marrë parasysh se nuk kemi mundësi tjera, kemi ardhur në përfundim, në koordinim edhe me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave që të barten 150,000.00€, nga një kod ku ne e kemi për një furnizim të tillë, të cilin nuk mund të realizojmë, të barten në një kod tjetër që pastaj të mundemi t'i destinojmë

ato mjete financiare për blerjen e invertarit. Unë pres që ky propozim të përkrahet nga ana e juaj dhe të kemi mundësi që të furnizojmë shkollat tona me invertarë.

Filloreta Musaj: Drejtori e sqaroi shumë mirë propozimin dhe nevojën për inventarë në shkollat e komunës, andaj në emër të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrahim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

Laureat Gojnovci: Unë ju uroj për fillimin e vitit të ri shkollorë dhe kërkoi nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit që të bënë gjithë çka që është në mundësinë e tij, për fillimin e mësimit në shkollën e fshatit Lismir. Ky material ka anomali, jeni thirrur në nenin 15 të Ligjit për ndarje buxhetore, ky nenë e lejon lëvizjen e mjeteve brenda investimeve kapitale, këtë propozim është dashur ta përgatitë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe jo Drejtoria e Arsimit, në këtë mënyrë ju jeni duke ndërhyrë në projeksionet buxhetore të vitit 2026, ky është propozimi i pestë që po prek në buxhetin e aprovuar, jashtë rregullave të lejuara për ndryshime në buxhetin e komunës, me Ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2026. Ne sqarimet për këtë ridestinim të buxhetit duhet t'i marrim nga Drejtori për Buxhet dhe Financa.

Dardane Sogojeva Shala: Tani propozimi për shkollën e re 'Fazli Grajçevci' në Fushë-Kosovë për invertarë, nuk është i arsyeshëm, sepse objekti shkollorë ende nuk është përfunduar, ju po ashtu duhet të dilni dhe të vizitoni edhe shkollat tjera nëpër fshatra, sikur është shkolla në fshatin Sllatinë e Madhe, e cila ka nevojë për lyerjen e saj dhe inventarë të ri.

Drejtori për Arsim: Shkolla 'Bajram Curri' është në program për renovim.

Ali Ismaili: Tani sot ka filluar viti i ri shkollorë, i urojmë të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit për një vitë të mbarë shkollorë. Shkollat tona dihet si janë ndërtuar, u mungojnë laboratorët dhe gjërat tjera të nevojshme për mësim, mësimdhënësit kanë vështërsi në kryerjen e punës së tyre. Tani Kryetar i Komunës, në cilësinë e propozuesit të pikave të rendit të ditës nuk po janë prezentë në mbledhje të Komitetit për Politikë e Financa, është problem të diskutohet pa prezencën e tyre. Kur vie një pikë e rendit të ditës dhe kërkohen 150,000.00€, të merren nga një investim kapital, pse drejtor nuk na keni elaboruar se cilin investim nuk keni mundur ta realizoni deri në këtë muaj, meqenëse nuk po mundeni me e realizuar atë investim kapital, po i'a merrni paratë për një destinim tjetër, çka po mbetet keq te investimet kapitale. A lejohet ligjërisht që paratë nga investimet kapitale të barten në mallëra dhe shërbime, këtë duhet të na sqaron Drejtori për Buxhet dhe Financa. Ne si Komunë e Fushë-Kosovës në arsim jemi në pozitë të keqë, për arsye të numrit të madh të nxënësve dhe mungesës së perosnelit arsimorë, kemi marrë shumë vendime në Kuvendin e Komunës për arsim, po ashtu duhet të jemi të informuar saktë, cili investim kapital nuk po bëhet, pse duhet të ridestinohen këto mjete financiare, është fakt se planifikimin e buxhetit për këtë vit nuk e keni bërë ju, po ashtu ju jeni i ri në këtë pozitë, vetëm një muaj, unë shpresoj që me përkrahjen tonë për arsim dhe dijen e juaj i nderuari Drejtor i Arsimit, do të arrini të bëni disa gjëra të mira në fushën e arsimit, por pa bërë shkelje ligjore gjatë rrugës dhe veprimeve që do të ndërmerrni.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ky ridestinim i buxhetit, po bëhet për të mos humbur këto mjete financiare në këtë vitë buxhetor, është i lejuar të bëhet, megjithatë vendimi do të vlerësohet edhe nga Ministria e Financave para zbatimit të tij.

Ali Ismaili: Ne këtu nuk morëm elaborimin e nevojshëm, meqë mungon Kryetari i Komunës dhe Drejtori për Buxhet dhe Financa, nuk jemi të bindur pse ky buxhet duhet të ridestinohet në kategorinë ekonomike të mallërave dhe shërbimeve, a nevojiten këto mjete financiare për blerjen e lëndëve djegëse druve dhe qymyrit, apo për çka nevojiten, duam sqarime shtesë.
Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026'.
U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për ridestinimin e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026'.

Pika e tretë (3) - Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026'. Hap diskutimin.
Filloreta Musaj: Tani në emër të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrahim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026'.
Laureat Gojnovci: Kjo pikë është në shqyrtim nga Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, e cila nuk është prezente, për të na dhënë sqarimet e nevojshme, pse po i largoni investimet solare nga institucionet arsimore dhe shëndetësore, kjo nuk është në rregull si proces, po ashtu nuk kemi ndonjë sqarim pse nuk po realizohet ky projekt capital.
Dardane Sogojeva Shala: Unë si anëtare e Partisë Demokratike e Kosovës nuk do të marrë pjesë në votim.
Ali Ismaili: Ballafaqimi juaj është nën nivel të detyrës tuaj i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, ju këto pika i keni kundërshtuar në mandatin e kaluar, tani kanë ndryshuar rrethanat dhe po i përkrahni.
Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera pas të cilave Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026'.
U votua me: tre vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e përdori votën e dyfishtë, meqë rezultati i votimit ishte i barabartë, andaj në bazë të votimit konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me shumicë të

votave e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për ridestinimin e mjeteve financiare në investime kapitale për vitin 2026'.

Pika e katërt (4) - Propozim për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë'. Hap diskutimin.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrahim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë'.

Laureat Gojnovci: Si mundemi ta trajtojmë këtë pikë kur ka kaluar në fazat e prokurimit, a do ta shkëputni kontratën, a do të shtoni para për këtë investim, materialin e kemi në një faqe A 4, këtu mungon Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport, për të na dhënë sqarime shtesë, nuk ka ndonjë paramasë të re, si do të bëhet ky modifikim i projektit, ne jemi pro këtij propozimi, por si të veprojmë, ne nuk jemi kompetentë me modifikuar projektin. Ne i votojmë propozimet mirëpo kemi nevojë për sqarim.

Dardane Sogojeva Shala: Unë nuk do të marrë pjesë në votim, sepse mungojnë sqarimet për realizimin e këtij projekti me rëndësi për sportin dhe sportistët e Komunës së Fushë-Kosovës.

Ali Ismaili: Nuk kemi të dhëna se si do të bëhet ky modifikim, sa do të zgjerohet ky projekt, në pjesën e tribunave, zhveshtoreve apo fushës së gjelbërt, nuk e kemi një analizë për punën deri tani, as për veprimet në periudhën e ardhshme. Mungon projekti teknik, në këtë fletë është arsyetimi i përgjithshëm, mungon analiza e ndikimit në buxhet, nuk sqarohet nëse modifikimi do ta rris vlerën e projektit e tjera. Ju më herët keni thënë se kjo pronë është nën menaxhimin e Agjensisë Kosovare të Privatizimit dhe e keni kontestuar investimin në fjalë.

Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera pas të cilave Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë'.

U votua me: tre vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e përdori votën e dyfishtë, meqë rezultati i votimit ishte i barabartë, andaj në bazë të votimit konstatoi se Komiteti për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e 'Propozimit për modifikimin e projektit zbatues për renovimin dhe zgjerimin e Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë'.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2026-2030

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtimin 'Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2026-2030'. Hap diskutimin.

Laureat Gojnovci: Këtë punë e ka bërë Ish/Drejtori për Zhvillim Ekonomik z. Ekrem Berjani, nuk ka ndonjë ndryshim substancial në dokumentin e kësaj strategjie për zhvillim ekonomik.

Ali Ismaili: Po shprehi disa shqetësime për këtë projekt-strategji ku duhet të shtohet kujdesi i Ekzekutivit të Komunës. Plani i veprimit 2026, në koston totale ka 17,829,000€, dokumenti përmend se burim i buxhetit komunal, grantet qeveritare, donator dhe sektor privat, sa para prej këtyre janë të siguruara sot? Dokumenti tregon se 83% e buxhetit të komunës varet nga grantet qeveritare ndërsa 17% nga të hyrat vetanake, kjo duhet të ju bënë më të vetëdijshëm sepse nuk e dimë, se sa do të mund të zbatohet si strategji.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Besoj se gabimet terminologjike do të rregullohen deri në leximin e dytë, nëse s'ka diskutime tjera po e qesim në votim 'Propozimin për shqyrtimin e parë të Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2026-2030'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovoi për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e parë të Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2026-2030', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për shqyrtimin e parë të 'Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2030'.

Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim Projekt-Rregulloren për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë Kosovës, shqyrtimi i parë ka përfunduar, dëgjimi publik është mbajtur, nuk ka ndryshime të mëdha. Hap diskutimin.

Meqë nuk ka diskutime tjera po e qesim në votim për shqyrtimin e dytë të 'Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: tre vota 'për', dy votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e aprovoi për procedim dhe shqyrtimin e dytë në Kuvendin e

Komunës 'Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', këtë:

R e k o m a n d i m

Për aprovimin të 'Projekt-Rregullores për lëshimin e lejeve për instalimin e paneleve foto-voltaike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'

Pika e shtatë (7) - Të ndryshme.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar kolegë, a ka dikush diçka tek pika të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 11:10 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani